

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, të mbajtur më 29.04.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 nga Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi Kërkesën për miratimin e mendimit juridik parimor, të paraqitur nga Illko Petrov nga Shkupi, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Kërkesa për miratimin e mendimit juridik parimor, e paraqitur nga Illko Petrov nga Shkupi, e evidentuar nën SU-03.nr.211/24 të datës 18.03.2024, HIDHET POSHTË.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nga Ligji për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 29.04.2024 shqyrtoi mbi Kërkesën për miratimin e mendimit juridik parimor Su-03.nr.211/24 të datës 18.03.2024, të paraqitur nga Illko Petrov nga Shkupi.

Në këtë kërkesë, paraqitësi propozon që Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratojë mendim juridik parimor sa i përket pyetjes “A duhet që gjykata civile t’i analizojë apo jo ligjshmëritë e vendimeve kontestuese në kontest civil kur paditet RMV për të kompensuar dëmin?”.

Në përputhje me nenin 37 paragrafi (1) nënpika 1 nga Ligji për gjykatat, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje të rëndësishme për sigurimin e barazisë me zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tre muajsh, por jo më gjatë se gjashtë muaj me vetiniciativë apo me iniciativë të kryetarit të gjykatës apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo sektorëve gjyqësor të gjykatave apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vendosur mbi kërkesën – iniciativën konstatoi se e njëjta është paraqitur nga një person fizik dhe jo nga një subjekt që sipas dispozitës së sipërcituar është i autorizuar për paraqitjen e iniciativës.

Duke marrë parasysh të ekspozuarën, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut konstaton se kërkesa Su-03.nr.211/24 të datës 18.03.2024 duhet të hidhet poshtë pasi që nuk është paraqitur nga një subjekt i autorizuar, në përputhje me nenin 37 paragrafi (1) nënpika 1 nga Ligji për gjykatat.

Seanca e përgjithshme
e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut